



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT TË ANËTARËVE TË SHOQATËS SË TË VERBËRVE TË KOSOVËS



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

NENI 1 QËLLIMI

Kjo rregullore përcakton fushëveprimin dhe funksionin e Kuvendit të Anëtarëve në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës.

NENI 2 POZITA NË HIREARKI

Kuvendi i anëtarëve është organi më i lartë vendimmarrës në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës.

NENI 3 PËRPUTSHMËRIA ME STATUTIN DHE LIGJET

Kjo Rregullore duhet të jetë në përputhje të plotë me Statutin e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës dhe Ligjet e aplikueshme në fuqi në Republikën e Kosovës, dhe asnjë dispozitë nuk mund të jetë në kundërshtim me këto instrumente.

NENI 4 PËRBËRJA

Kuvendi i anëtarëve përbëhet nga delegatët e përzgjedhur nga shoqatat komunale dhe ndërkomunale të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

Përfaqësimi në kuvend nga shoqata ndërkomunale dhe komunale, shkon me proporcionin 1 delegatë qw përfaqëson 50 anëtar.

NENI 5 ZGJEDHJA E DELEGATËVË NË KUVEND LOKAL

Tubimet zgjedhore organizohen në secilën komunë, për të zgjedhur delegatët lokal në proporcionin 1 delegatë me 20 anëtarë.

Organizimi teknik i tubimit zgjedhor është në përgjegjësinë e strukturës organizative të shoqatës ndërkomunale për komunat përkatëse.

Tubimet zgjedhore në komunat përkatëse, kanë për qëllim vetëm përcaktimin/ zgjedhjen e delegatëve për Kuvend të shoqatës ndërkomunale.

NENI 6 PROCEDURA E ZGJEDHJES SË DELEGATËVE LOKAL

Të gjithë anëtarët kanë të drejtë të jenë të propozuar për delegatë në nivel lokal.



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

Pasi të evidentohen të propozuarit, anëtarët votojnë për të përzgjedhur delegatët lokal, në proporcionin 1 delegatë për 20 anëtarë.

Si delegatë lokal përzgjidhen më të votuarit, deri sa të përmbushet numri i përcaktuar në bazë të kuotës 1 me 20.

Në rast se votimi nuk prodhon rezultatet e nevojshme, i njëjti mund të përsëritet disa herë.

Pasi të përzgjidhen delegatët lokal, anëtarësia mund të shpërndahet dhe delegatët e përzgjedhur, zgjedhin kryesinë dhe delegatët për nivel qendror (1/50).

Ne rastet kur numri i anëtarëve është i vogël, e rrjedhimisht edhe numri i delegateve lokal është më i vogël se 7, struktura udhëheqëse në nivel lokal përzgjidhet direkt nga anëtarët në tubimin zgjedhor.

Përfaqësimi i grave në nivel lokal për sa i përket delegatëve duhet të jetë së paku 30%.

NENI 7

ZGJEDHJA E KRYETARIT TË SHOQATËS KOMUNALE/ NDËRKOMUNALE

Për të zgjedhur kryetarin e degës, një delegat lokal duhet të sigurojë së paku 2 nënshkrime për tu propozuar si kandidatë për kryetar.

Pasi të sigurohen të gjitha propozimet, kandidaturën votohen nga delegatët lokal.

Kryetari i degës zgjidhet me shumicë votash të delegatëve lokal.

NENI 8

ZGJEDHJA E NËNKRYETARIT TË SHOQATËS KOMUNALE/ NDËRKOMUNALE

Kryetari i përzgjedhur ka të drejtë të emërojë në mënyrë automatike një nënkryetar nga radhët e delegatëve lokal.

NENI 9

ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TW SHOQATWS KOMUNALE/ NDËRKOMUNALE

Pjesa e mbetur e delegatëve lokal kandidohen në mënyrë automatike për anëtarë të Këshillit Drejtues lokal, përpos në rastet kur dikush vendos të tërhiqet.

Ai që tërhiqet duhet të deklarohet para votimit.

Pjesa tjetër e anëtarëve janë automatikisht në garë për pjesën e mbetur të strukturës së Këshillit Drejtues.



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

NENI 10

ZGJEDHJA E DELEGATËVE TË KUVENDIT TË ANËTARËVE

Kryetari i përzgjedhur në nivel lokal, është në mënyrë automatike delegat në nivel qendror.

Pjesa tjetër e delegateve në nivel qendror, zgjidhen nga delegatet në nivel lokal, në varësi të kuotës 1 me 50 në nivel të anëtarësisë së përgjithshme lokale.

Kandidatet nuk kanë të drejtë të propozojnë dhe nuk kanë të drejtë të votojnë për vetën e tyre.

Pasi të përcaktohet lista e propozimeve, e njëjta kalon në votim.

Votim i përmbledhur bëhet nëse lista e propozimeve është e barabartë me numrin e delegateve që do të shkojnë në nivel qendror.

NENI 11

KOMPETENCAT E KUVENDIT

Kuvendi i anëtarëve është organi përgjegjës për vendimmarrje strategjike në kuadër të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

Kuvendi miraton raportet vjetore narrative, financiare, dhe dokumentet e tjera të planifikimit strategjik të shoqatës.

Në bazë të raporteve vjetore narrative dhe financiare, Kuvendi i Anëtarëve e vlerëson performancën e Këshillit Drejtues dhe mund të jap rekomandime relevante.

Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe Këshillin Drejtues të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

NENI 12

ZGJEDHJA E KRYETARIT

Thirrja e kandidaturave për kryetar duhet të shpallet së paku 45 ditë para mbajtjes së Kuvendit. Thirrja për kandidaturë publikohet në rrjetet zyrtare të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

Afati i fundit i paraqitjes së kandidaturës dhe programit përkatës nga kandidatët e interesuar është 15 ditë para mbledhjes.

Kandidatura pranohet vetëm kur ajo është e nënshkruar nga së paku 8 delegatë qendror nga së paku 3 shoqata komunale dhe ndërkomunale.

Kriteret kryesore për të paraqitur kandidaturën janë si në vijim: së paku shkollimi i mesëm i lartë, anëtarësia e rregullt në shoqatë, të mos ketë pasur histori penale, dhe të mos jetë nën hetim.



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

Delegatët e kuvendit kanë të drejtë të mbështesin vetëm një kandidaturë.

Kandidatura duhet të dorëzohet në Arkivin e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, dhe të njëjtat duhet të publikohen në webfaqën e shoqatës.

Kandidatët duhet të prezantojnë programin e tyre në mbledhjen zgjedhore të kuvendit.

Pas prezantimit të programeve, procedohet me zgjedhjen e kryetarit të shoqatës.

Kryetari zgjidhet me shumicë votash.

NENI 13 PROCEDURA E ZGJDHJES SË KËSHILLIT DREJTUES

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues mund të bëhet me një propozim nga një grup prej së paku 5 anëtarëve të Kuvendit nga 3 degë të ndryshme të organizatës, të cilët dakordohen për të propozuar një emër si anëtar i Këshillit Drejtues.

Të propozuarit për anëtarë të Këshillit Drejtues të cilët konfirmojnë kandidaturën e tyre pas propozimit, duhet të prezantojnë vetën e tyre(përgatitjen e tyre profesionale, dhe vizionin e tyre për avancimin e personave të verbër ne shoqëri) para anëtarëve të Kuvendit.

Kuvendi i Anëtarëve ka të drejtë të shkarkojë Këshillin Drejtues në rast se i njëjti ka 1) shkelur Statutin e Shoqatës, 2) ka tejkaluar kompetencat e Këshillit Drejtues, 3) kur ka pasur performancë të ultë dhe 4) kur janë dorëhequr së paku 1/3 e anëtarëve të tij.

NENI 14 MËNYRA E VOTIMIT

Mënyra e votimit përcaktohet në fillim të tubimet zgjedhor, të hapur, me deklaram dhe të mbyllur.

Me shumicë votash me ngritje dore.

NENI 15 MANDATI I STRUKTURAVE TË ZGJEDHURA

Zgjedhjet lokale dhe qendrore mbahen çdo 5 vjet dhe rrjedhimisht mandati i strukturave te zgjedhura është 5 vjeçar .



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

NENI 16

TAKIMET E KUVENDIT TË ANËTARËVE

Kuvendi i anëtarëve mbledhet në takime të rregullta një herë në vit.

Kuvendi i anëtarëve mund të mbledhet edhe më shpesh në takime të jashtëzakonshme.

Takimet e jashtëzakonshme të kuvendit të anëtarëve duhet të ftohen nga Kryetari i Organizatës, nga shumica e Këshillit Drejtues apo edhe nga 1/3 e të gjithë anëtarëve.

Takimet e rregullta duhet të realizohen me prezencë fizike të anëtarëve

Takimet e jashtëzakonshme mund të realizohen edhe me prezencë virtuale të anëtarëve.

Takimet e Kuvendit të anëtarëve planifikohen dhe thirren rregullisht nga Kryetari për shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve në kompetencë të këtij organi.

Thirrja për mbledhjen u komunikohet Kuvendit të anëtarëve nëpërmjet njoftimit me shkrim apo njoftimit elektronik. Njoftimi duhet të përmbajë datën, orën, vendin, rendin e ditës dhe duhet të dërgohet së paku 15 ditë punë përpara kohës kur do të zhvillohet mbledhja e rregullt.

NENI 17

KUORUMI

Kuorumi i nevojshëm për një mbledhje të Kuvendit të Anëtarëve konstatohet me prezencën e më shumë se gjysmën e anëtarëve të tij.

NENI 18

TRUPAT ORGANIZATIVE TË ZGJEDHJEVE

Kuvendi i anëtarëve në nivel qendror duhet të ketë trupat si në vijim:

1) Komisioni Statutar

Roli i këtij komisioni: është analizimi i dispozitave statutare, sigurimi i përputhshmërisë me ligjet në fuqi dhe mandatin e organizatës, shtrimi i kërkesave për plotësim/ndryshime të statutit dhe i rekomandimeve sipas qëndrimeve të tij, mbikëqyrja dhe monitorimi i zbatimit të statutit.

Komisioni Statutar duhet të ketë 3 anëtarë, 2 prej të cilëve zgjidhen me shumicë votash nga radhët e delegatëve të kuvendit dhe një duhet të jetë ekspert i jashtëm juridik.

2) Këshillin Mbikëqyrës.



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

Roli i këshillit mbikëqyrës është të analizoj raportet vjetore narrative dhe financiare dhe të bëjë paraqitjen e tyre para kuvendit së bashku me një raport të analizës së tyre.

Këshilli Mbikëqyrës duhet të ketë 3 anëtarë, 2 prej të cilëve zgjidhen me shumicë votash nga radhët e delegatëve të kuvendit dhe një duhet të jetë ekspert i jashtëm ekonomik.

3) Sekretaria e Kuvendit:

Roli i sekretarisë së Kuvendit, është mbajtja e procerverbalit, verifikimi i kuorimit dhe numërimi i votave.

Sekretaria e Kuvendit autorizohet nga Këshilli Drejtues dhe duhet të ketë 3 anëtarëve, të cilët vinë nga radhët e stafit qendror të Shoqatës apo vullnetarëve lokal.

4) Kryesia e punës:

Roli: Drejtoj, moderoje dhe të sigurohet për mbarëvajtjen seancën e kuvendit. Gjithashtu të

Përbërja: Kryetarit apo Kryesuesit dhe minimum dy delegatë që i përcakton Kryetari.

5) Komisioni Zgjedhor:

Roli i këtij komisioni është që të sigurojë mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore në Kuvend.

Ky komision zgjidhet çdo 5 vite, dhe përbëhet nga 5 anëtarë, dy prej të cilëve duhet të jenë delegatë, dhe 3 të tjerë nga radhët e stafit.

NENI 19 MEDITJET

Pagesat për të dyja komisionet përcaktohen nga Këshilli Drejtues në dakordim me anëtarët e brendshme të komisioneve dhe ata të jashtëm apo ekspertët.

NENI 20 PROCESVERBALI

Lidhur me punën e Kuvendit të Anëtarëve mbahet procesverbali përkatës.

Procesverbali mbahet nga sekretaria e kuvendit i autorizuar nga Kryetari për kryerjen e kësaj detyre .

Procesverbali përmban të dhënat kryesore për mbledhjen ,përkatësisht për rrjedhën e saj dhe nuk kufizohet në informatat si në vijim:

- numrin e seancës,
- datën e mbajtjes,
- vendin e mbajtjes,
- orën e fillimit dhe mbarimit,



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

- numrin e të pranishmëve dhe emrat e anëtarëve të Këshillit Drejtues që mungojnë nga mbledhja,
- emrat e personave të tjerë të ftuar që marrin pjesë në punën e mbledhjes;
- propozimet e paraqitura,
- rendin e ditës,
- vendimet dhe konkluzat e miratuara në mbledhjen e Këshillit Drejtues ,
- rezultatet e votimit për pikat e caktuara etj.

Proces-verbali mbahet në një bllok të lidhur dhe me numër rendor të protokolluar.

Çdo proces verbal miratohet nga të gjithë anëtarët e Kuvendit në fund të seancës, pasi të lexohet.

NENI 21

HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj me Vendim të Kuvendit të Anëtarëve.